



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2021:228800  
Datë: 08.12.2021  
Numri i dokumentit: 02484691

**C.nr.1014/2021**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Qmega** në çështjen juridike të paditësit E. A. Z. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar I. H., kundër të paditurve A. Z. S., Sh. Z. N., Xh. Z. K., H. Z. K. dhe L. Z. K. që të gjithë nga Rahoveci, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati G. Sh. nga Rahoveci, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e kontestit 1.000,00 €uro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më **17.11.2021**, merr këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit, **SI E BAZUAR**.

**VËRTETOHET** se paditësi **E. (A.) Z.** është pronarë i parcelës kadastrale nr. **2116-4**, me kulturë “Vresht i kl.2”, në vendin e quajtur “Kërstiq”, në sipërfaqe prej **587 m<sup>2</sup>**, ZK Rahovec, në bazë të parashkrimit fitues, çka të **paditurit** A. S., Sh. N., Xh. K., H. K. dhe L. K. janë të **obliguar** që të pranojnë këtë të drejtë dhe të lejojnë që paditësi të regjistrohet si pronarë në regjistrin Kadastral të Pronave pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Rahovec, ku si bazë juridike do të shërbejë ky aktgjykim dhe atë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin të përmbarrimit të detyrueshëm.

**Shpenzimet procedurale sipas marrëveshjes i bart paditësi.**

## **A r s y e t i m**

Paditësi E. A. Z. ka ushtruar padi kundër të paditurve A. S., Sh. N., Xh. K., H. K. dhe L. K., për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar disa seanca e shqyrtimin kryesor, në të cilat janë paraqitur i autorizuar i paditësit I. H., ndërsa për të paditurit, përfaqësuesi i autorizuar avokati G. Sh..

I autorizuari i paditësit I. H., ka deklaruar se: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, është fakt i pakontestueshëm se paditësi nga e ndjera Z. Sh. K., trashëgimlënësja këtu e të paditurve, në vitin 1999, me kontratë gojore e ka kryer shitblerjen e parcelës me nr.2116-4, e cila është në sipërfaqe prej 0.05,87 ha, që gjendet në vendin e quajtur Krstiqe, ZK Rahovec, në shumë të përgjithshme prej 2,000.00 marka të atëhershme, të cilin çmim ia ka paguar në tërësi tani të ndjerës, Z. K. dhe që nga ajo kohë ai është shfrytëzues dhe posedues i parcelës pa u penguar nga askush. I ka propozuar gjykatës që të dal në vend dhe pretendimet e t’ia ti vërtetoj dhe së bashku me ekspertin gjeometër të bëj identifikimin e parcelës dhe pas shqyrtimit të provave padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve avokati G. Sh., ka deklaruar se: pronar faktik dhe posedues me mirëbesim i paluajtshmërisë kontestuese, është paditësi, ngase të njëjtën e mban në mënyrë të ligjshme dhe me mirëbesim më shumë se dy dekada. Nuk e konteston kërkesëpadinë për faktin se paditësi nga e ndjera, paraardhësja e të paditurve e ka blerë parcelën që është objekt i këtij kontesti, shumën e kontraktuar e ka paguar që nga koha e shitblerjes dhe paditësi që nga ajo kohë ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të lirë të parcelës në fjalë. Të gjitha këto të thëna të paditurit me rastin e dhënies së autorizimit të tyre që të njëjtit të i përfaqëson kërkon që të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me bartjen e kësaj paluajtshmërie të bien në barrë të paditësit pasi që e atillë ka qenë marrëveshja e atëhershme. Nuk i kundërshton provat e propozuara dhe në fund i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të vendosë në harmoni me provat materiale.

Për të vërtetuar faktet vendimtare, gjykata i ka zbatuar këto prova: ka bërë shikimin në certifikatën e pronësisë të parcelës nr.2116-4 të datës 11.10.2021, ka bërë shikimin në aktvdekjen për të ndjerin Z. K., të datës 05.10.2021 dhe ka bërë shikimin e ekspertizës dhe skicës së terrenit të datës 09.11.2021.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç, duke i vlerësuar në deklaratat e ndërgjyqësve si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 7 dhe 8 të LPK-së, në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesë padia e paditësit është **e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.**

Nga provat të zbatuara është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Me shikimin në certifikatën e pronësisë të datës 11.10.2021, ZK Rahovec, vërtetohet se parcela kadastrale nr.2116-4, që gjendet në vendin e quajtur “Kërstiq”, në sipërfaqe të përgjithshme prej 587 m<sup>2</sup>, evidentohet në emër të Z. Sh. K..

Me shikimin në aktvdekjen e të ndjerit Z. K., të datës 05.10.2021, vërtetohet se prej trashëgimtarëve ka lënë A. S., Sh. N., Xh. K., H. K. dhe L. K..

Me shikimin në ekspertizën dhe skicës së terrenit të kompanisë G.-L. të datës 09.11.2021, është konstatuar se: parcela kontestuese nr.2116-4 me sipërfaqe prej 587 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Kërstiq”, ZK Rahovec, me kulturë “Vresht i kl.2”, sipas evidencës në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë në Rahovec, evidentohet në emër të Z. K. në pjesë ideale 1/1. Parcela kontestuese nr. 2116-4 në terren shfrytëzohet si tokë ndërtimore me kulturë shtëpi dhe oborr. Parcela në fjalë me nr.2116-4 kufizohet në veri – lindje me parcelën nr. 2117-10 (Rrugë), në jug-lindje me parcelën nr. 2116-5, në jug – perëndim me parcelën nr. 21150-0 dhe në veri-perëndim me parcelën nr. 2116-3.

Si fakte relevantë në këtë çështje juridike, gjykata merr për bazë se është argumentuar fakti se paditësi është në posedim të ligjshëm dhe mirëbesim dhe paraardhësi i të paditurve i ka pranuar të hollat, dhe se të paditurit nuk kanë kundërshtuar që paluajtshmëria të bartet në emër të paditësit.

Ligji për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore me dispozitën e nenit 40.1 parasheh se: **Personi i cili me mirëbesim e ka njëzetë (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të**, sipas kësaj gjendje të vërtetuar gjykata vlerëson se

paditësi në shfrytëzim të pronës është vendosur posedim të ligjshëm dhe mirëbesim rreth mbi 20 vite, i cili kusht është plotësuar edhe me LTHMPJ-së, sipas dispozitës së nenit 28. 4.

Në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 28. 4 të LTHMPJ-së, dhe nenit 40. 1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, si dhe neneve 143 dhe 254 dhe 319 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

**Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**C.nr.1014/2021, më 17.11.2021**

**B. Profesional**  
**Armond Qmega**

**Gjyqtari**  
**Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.